



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0020

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AGRI BAU SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1, me 01.04.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserishte e bazuar ankesa e OE AGRI BAU SH.P.K. me nr. 2025/0020, e datës 06.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.
2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjeserishte e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.09.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 €.

Me 18.12.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE AGRI BAU SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.

Me 23.12.2024, OE AGRI BAU SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 27.12.2024.

Me 06.01.2025, OE AGRI BAU SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0020, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik AGRI BAU SH.P.K., lidhur me ankesën 0020/2025:

Pretendimi 1: Përdorimi i Shportave ngritëse dhe dokumentacioni i kërkuar

OE thekson se Autoriteti Kontraktues (AK) ka kërkuar dokumente të caktuara, si deklarata doganore, libreza qarkullimi, dhe marrveshje për shfrytëzimin e shportave ngritëse, por nuk ka specifikuar nëse kërkohet përdorimi i shportave autoshporta, shportave hidraulike, apo një lloj tjetër. OE pohon se ka paraqitur dokumente të nevojshme për të dëshmuar se disponon shportat ngritëse (autoshporta dhe kamion me shporta në pronësi të saj) dhe se nuk ka pasur nevojë për nënkontraktim.

OE argumenton se kërkesa për të paraqitur marrveshje për shfrytëzimin e shportave ngritëse është i mjaftueshëm dhe se AK ka vepruar në mënyrë tendencioze dhe jo profesionale kur kërkon një konzorcium ose nënkontraktor për këtë pjesë të kontratës. Në këtë rast, OE argumenton se kërkesa ishte për "kapacitetin teknik dhe profesional" dhe se nuk ishte kërkuar në mënyrë eksplicite që të paraqitet si nënkontraktor. Për këtë arsye, ata pretendojnë se AK po përpiqet të shmangë kriteret e parashikuara në FTD dhe po përdor një vlerësim joprofesional për të

eliminuar ofertën e tyre.

Pretendimi 2: Rishqyrtimi dhe pezullimi i procedurës së prokurimit

OE argumenton se AK ka anuluar njoftimin për kontratë vetëm për Lotin 1 dhe ka rivlerësuar procesin e prokurimit pa zbatuar rregullat e përcaktuara nga Ligji mbi Prokurimin Publik (LPP) dhe rregulloret përkatëse. OE thekson se sipas nenit 108/A të LPP-së, dorëzimi i kërkesës për rishqyrtim duhet të çojë në pezullimin automatik të procedurës, por kjo nuk ka ndodhur në këtë rast. Po ashtu, OE pohon se nuk është respektuar afati i parashikuar për pezullimin dhe publikimin e kërkesës për rishqyrtim në platformën elektronike, siç kërkohet nga Neni 61 i Rregullores nr.002/2024.

Pretendimi 3: Rivlerësimi i ofertës dhe trajtimi i dokumenteve të kërkuara

OE thekson se, pasi është bërë ri-vlerësimi i ofertës për Lotin 1, AK ka kërkuar sqarime për dokumentet e ATK-së dhe certifikatën ISO, dhe këto kërkesa janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të ngadaltë. OE pohon se dokumentet janë dorëzuar në kohë dhe janë të vlefshme, por AK ka vazhduar me një rivlerësim tendencioz për të vonuar nënshkrimin e kontratës. OE po ashtu thekson se kërkesa për verifikimin e dokumenteve është bërë jashtë afateve të përcaktuara ligjore dhe se është kërkuar sqarim për një dokument që mund të verifikohet në mënyrë automatike në sistemin e ATK-së.

OE gjithashtu pohon se AK ka diskriminuar ofertat duke trajtuar në mënyrë të pandershme ofertën e tyre, duke mos respektuar principet e barazisë dhe transparencës të përcaktuara në LPP. Kjo ka sjellë një vonesë të padrejtë në procesin e prokurimit dhe një vendim të pabazuar për anulim dhe rivlerësim të ofertës së tyre.

Analiza ligjore e pretendimeve:

Për Shportat ngritëse (Kriteri 9.1 dhe 9.2): Sipas LPP-së, çdo kërkesë për nënkontraktim duhet të bëhet e qartë në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në këtë rast, nuk ka pasur kërkesë eksplicite për nënkontraktim për shportat ngritëse. Sipas OE-së, ata kanë paraqitur dokumente që vërtetojnë disponimin e shportave dhe nuk është kërkuar që ato të jenë pjesë e një konsorciumi. Pavarësisht kësaj, AK ka kërkuar që të paraqiten si nënkontraktor, duke e konsideruar këtë si një shmangie të kritereve të përshkruara në FTD.

Rishqyrtimi dhe pezullimi i procedurës (Neni 108/A i LPP): Sipas LPP-së, dorëzimi i kërkesës për rishqyrtim duhet të pezullojë automatikisht procedurën e prokurimit. Kjo nuk është respektuar nga AK, dhe OE pohon se nuk ka pasur pezullim automatik dhe nuk është bërë publikimi i kërkesës për rishqyrtim në platformën elektronike, që është një shkelje e rregulloreve të prokurimit publik.

Rivlerësimi dhe trajtimi i dokumenteve (Neni 59 dhe 40.2.1 i LPP): OE thekson se kërkesat për sqarimin e certifikatës ISO dhe marrëveshjes me ATK janë të panevojshme dhe se AK ka tejkaluar kompetencat e saj në rivlerësimin e ofertës. OE është shpallur fituese në një tender të ngjashëm më parë, dhe dokumentet që ata kanë dorëzuar janë të vlefshme dhe të pranueshme sipas kërkesave të FTD-së.

Diskriminimi dhe shkelja e parimeve të LPP-së: OE ka argumentuar se AK ka diskriminuar në mënyrë të padrejtë ofertat dhe se ka shkelur parimet e barazisë dhe transparencës që kërkohen nga LPP-ja. Kjo është në kundërshtim me Nenin 6 dhe 7 të LPP-së, që kërkon trajtim të

barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

Përfundim dhe rekomandim:

Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara, është evidente se OE ka siguruar dokumentacionin e kërkuar, ka plotësuar kriteret e kërkuara dhe ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga FTD. Megjithatë, vendimi i AK-së për eliminimin e ofertës dhe kërkesat për nënkontraktim janë të diskutueshme dhe nuk përputhen me ligjin dhe rregulloret për prokurimin publik.

OE ka argumentuar se AK ka abuzuar me pozitat e saj, duke bërë një rivlerësim të tendencioz dhe duke shkelur procedurat ligjore. Rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin e tij dhe të sigurojë që procesi të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore dhe të ofrojë një trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha palët.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "Agri Bau SHPK" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender" me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1. Pas shqyrtimit paraprak, është konstatuar se kërkesa është e lejuar dhe e parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, duke plotësuar kushtet për shqyrtim merititor. Parashtruesi pretendon se kërkesa për dy shporta ngritëse nuk është e specifikuar si duhet dhe se kërkesa për dokumentacion si deklarata doganore, librezat e qarkullimit, apo marrëveshje për përdorimin e shportave nuk është përfshirë në dokumentacionin e tenderit. Ai gjithashtu argumenton se nuk është kërkuar ofertë për ndonjë pozicion të shportave dhe se ka dorëzuar dokumentacion të kontratave dhe marrëveshjeve që mbështesin përdorimin e dy shportave të ngritëse. Sipas tij, kontratat e dorëzuara janë për përdorimin e shportave gjatë punëve që do të realizohen nga "Agri Bau SHPK" dhe nuk janë të natyrës së nënkontraktimit. Po ashtu, ai thekson se marrëveshjet e përmendura janë të vlefshme dhe të lidhura me përdorimin e shportave dhe nuk kanë të bëjnë me ndonjë nënkontraktim të pozicionëve të tenderit. Parashtruesi konteston eliminimin nga tenderi, duke argumentuar se oferta e tij nuk ka qenë e papërgjegjshme dhe se pretendimet e tjera të ngritura për certifikatat ISO dhe marrëveshjet me ATK-në janë të pavend dhe të pabazuara. Në përgjigje të këtyre pretendimeve, Autoriteti Kontraktues ka analizuar dokumentacionin dhe ka gjetur se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar marrëveshje për përdorimin e shportave ngritëse siç kërkohet në dokumentet e tenderit, por ka paraqitur marrëveshje për angazhimin e kompanive që i posedojnë ato, pa qenë këto të nënkontraktuara nga "Agri Bau SHPK". Kështu, është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme dhe është eliminuar drejtë nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Pas shqyrtimit të të gjitha elementeve të tenderit dhe kërkesave ligjore, kërkesa për rishqyrtim është refuzuar në mënyrë të plotë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 15.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0020, ndërsa me datë 24.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0020 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AGRI BAU SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0020 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje e ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 1;

Arsyetimi i AK për eliminim në pretendimin 1;

Ju si OE nuk keni dorëzuar pajisjet sipas kërkesës së DT-së; Operatori ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Dy shporta ngritëse për montim të ndriçimit dhe dekorimeve.

Dëshmia dokumentare; 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrëveshjes për shfrytëzimin e tyre.

Operatori Ekonomik ankues jep këtë arsyetim në lidhje me këtë pik të eliminimit;

Ne si OE kemi ofruar dokumentacionin Kontratave-Marrëveshjeve se kemi në shfrytëzim apo dispozicion dy auto shporta dhe një kamion vinç me shportë në pronësi tonën ashtu siç kërkohet tek FTD.

Në lidhje me këtë pretendim të Operatorit Ekonomik ankues, Eksperti Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimin ankimor, në DT, te kërkesa 9.1 dhe 9.2 është kërkuar.

OE ankues në ofertën e tij ka dorëzuar certifikatën e regjistrimit të automjetit me nr. 01-368-JB (librezën), në emër të “Anea Group” SH.P.K , dhe Kontrat-Marrveshje, për angazhimin dhe kryerjen e punëve me mjetin motorik gjegjësisht kamionete me korp VOLSWAGEN-VW, LT46.

Certifikatën e regjistrimit të automjetit me nr.01-507-QI (Librez), në emër të “Blini Cleaners” SH.P.K dhe Kontrat-Marrveshje, për angazhimin dhe kryerjen e punëve me mjetin motorik gjegjësisht kamion special “KORPA” MAN L200.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se Kontrat-Marrveshja në mes të OE:Agribau SHPK dhe OE:ANEA GROUP shpk, është dorëzuar pas kërkesës për sqarim nga AK. Andaj e rekomandon Autoritetin Kontraktues, që gjat kërkesës për sqarime duhet të sigurohet që të respektohet neni 72 i LPP, ku te pika e 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm

për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Pra në këtë rast Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh që të kërkojë dëshmi që e vërtetojnë ekzistencën e një dokumenti gjatë fazës së tenderit. Prandaj, eksperti shqyrtues mendon, të aprovohet si pjesërisht e bazuar ky pretendim ankimorë.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 2;

Eksperti Shqyrtues, ka shqyrtuar këtë pretendim të OE, anukes dhe i njëjti në mënyrë kronologjike sqaron;

- Autoriteti Kontraktues me datën 06.11.2024, ka publikuar njoftimin për vendim B58,
- Operatori Ekonomik “Te Fatosi”, me datë, 11.11.2024, i pa kënaqur me vendimn B85 lidhur me lot 1, ju ka drejtuar AK, me kërkesën për Rishqyrtim.
- AK me datën 13.11.2024, e ka nxjerr vendimin mbi aprovimin e kërkesës për rishqyrtim të OE “Te Fatosi”, dhe njëherë lëndën e ka kthyer në rivlerësim.
- Operatori Ekonomik “Te Fatosi”, me datën 25.11.2024, ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, i njëjti me datë 27.11.2024, ka dorëzuar kërkesë për tërheqjen e ankesës.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë 02.12.2024, ka lëshuar vendimin mbi aprovimin e kërkesës së operatorit ekonomik “Te Fatosi”, ndërsa i lejohet AK, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit.
- Autoriteti Kontraktues me datën 17.12.2024, ka publikuar njoftimin për vendim B58.

Eksperti Shqyrtues, pas prezantimit të këtyre të dhënave në mënyrë kronologjike të cilat janë të cekura më lartë, si dhe shqyrtimit të tyre mendon se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 3;

Operatori Ekonomik, ankues në ofertën e tij ka prezantuar certifikatën e ISO 9001;20215 po të cilën e gjeni të bashkëngitur në raportin e ekspertizës.

Eksperti Shqyrtues ka konstatuar që kjo certifikatë ekziston, mirëpo pas verifikimit të QR Code, ky kot nuk jep asnjë të dhënë. Andaj rekomandoj që të kthehet në rivlerësim dhe rekomandon AK, që në bazë të nenit 72, të kërkojë sqarime dhe të verifikojë vërtetnin e këtij dokumenti të cilin e ka prezantuar operatorit ekonomik. Nëse Operatori Ekonomik ankues në këtë rast nuk mundet me dëshmuar vërtetnin e këtij dokumenti atëherë detyrohet AK që të veproj sipas nenit 99 të LPP.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 4;

Eksperti shqyrtues ka konstatuar që Operatori Ekonomik sipas kërkesës së AK ka dorëzuar vërtetimin tatimor të ATK, i cili e ka datën 30.09.2024, dhe përshkrimin e gjendjes tatimore; Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura. Prandaj eksperti mendon të aprovohet kjo pikë e ankesës dhe rekomandon AK që të kërkojë sqarime lidhur me këtë dokument se data e marrëveshjes a figuron para njoftimit për kontratë të këtij tenderi sipas interpretimit të KRPP. Po ja bashkëngjisë edhe

interpretimin;

22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në ato që u ceken si me lart, eksperti shqyrtues, mendon që ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlersim dhe të rekomandohet AK, që gjatë rivlersimit të kërkojë sqarime dhe ti verifikoj dokumentat e prezantuara në ofetën e operatorit ekonomik ankues para se të njejtin ta eliminoj.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender - DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI me numër të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar për faktin se lidhur me pretendimin nr 1 per

paisjet e ofruar te kërkuara nga AK-ja ne sipas DT dhe NJK , tek III.2.4) Kapaciteti teknik dhe professional ku jane kerkuar : tabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit ; ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***. Dy Shporta ngritese per montim te ndricimit dhe dekorimeve. 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrveshjet për shfrytezimin e tyre Dy Shporta ngritese per montim te ndricimit dhe dekorimeve. 3. Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrveshjet për shfrytezimin e tyre. Gjate egzaminimit te ofertes për çka është eliminuar edhe OE ankues është ofruar marrveshje sipas dates: 01.06.2022, ku OE angazhon OE BLINI CLEANEN per kryerjen e puneve pa specifikuar ndonje titull te aktivitetit apo nr te prokurimit, dhe se kontrata e till i bije te jetë nënkontraktues ngase ne nenin II te kësaj kontrate precizohet ‘ ***Periudha e kësaj kontrate eshte 3 vjeqare nga data e nënshkrimit te kontratës me mundësi vazhdimi , ndërsa çmimi per pune llogaritet ne ore /pune 20 euro/ h ose varesishte prej punëve dhe specifikave ne pune ku per qdo angazhim ne pune te caktuar do te behet caktimi i pagës sipas marveshjes per kryerje te asaj pune*** ‘ mbarim citati , dhe AK-ja me te drejte ka zbatuar nenin 60 te LPP-se , ndërsa lidhur me libezen e qarkullimit e ofruara Kamionet korpe me dy dyer ne pronësi te ANEA GROUP , ku gjate sqarimeve është ofruar marveshjen e datës :01.08.2024 ku ANEA GROUP është angazhuar per kryerjen e sherbimeve , ndersa ne kontratën e me hërshme me nr 616-22-5024-2-2-1 te lidhur me K.Prishtinës sipas dates : **20.07.2022** figuron si ***Grup i Operatorëve Ekonomik***, ndërsa në këtë procedur OE ankues ka hyrë si i vetëm dhe se kontrata - marrveshja e ofruar me ANEA GROUP ku citohet se eshte kompani me pron te përbashkët dhe drejtorin e kompanis dhe pjes e familjes te pronarve te dy kompanive kjo kontrate është ne emër te biznesit ‘ **ANEA GROUP** ‘ në këtë rast konsiderohet nënkontraktim sikurse përcaktohet në Neni 30 të LPP-së ku citohet ‘ ***Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Një indikator i tillë nuk ka efekt mbi detyrimin kontraktual nga tenderuesi në lidhje me autoritetin kontraktues apo të tjerët. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë, ku ata e konsiderojnë atë si të nevojshme, për pagesat direkte për nënkontraktorët***’. gjë që në oferten e OE ankues mungon informacioni mbi kontraktimin. Ashtu siq përcaktohet ne RrPP neni 17.19 , si dhe në Dosjen e Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit ku tek informacionet citohet :

Nënkontraktimet	12.1	a. një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit; dheb. Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.
-----------------	------	---

Në këtë rast Paneli Shqyrtues shpjegon se OE ankues nuk ka paraqitur nënkontraktimin sipas LPP-se dhe RrPP-së duke mos ofruar dëshmit sipas dëshmime te kërkuara **a** dhe **b**. Lidhur me pretendimin nr 3 sipas ankesës ku eshte thënë se pas kthimit ne ri-vlersim me datën 18.11.2024, keni kërkuar sqarime per dy pretendimet ankimore nr 1 lidhur me certifikatën ISO 9001;2025, dhe nr 2 marrveshjen me ATK-ne , ndërsa nga ana tjetër gjate këtij aktiviteti per Lot 2 keni marur vendim per shpërblim me kontrate per OE Te Fatos per te cilën nuk keni kërkuar asnjë verifim te certifikatës ISO. Panel Shqyrtues kërkon nga AK ja qe gjate rivlerësimit të bëjë verifikimin e ISO certifikatës.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues qe lënda duhet te kthehet ne rivlerësim mirpo konsideron që ankesa e OE ankues duhet aprovohet si pjeserishte e bazuar sipas arsytimit ne vendim ku kërkon nga AK-ja të anulohet B58Njoftimi mbi dhënie të

kontratës, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim sipas nenit 59 të LPP-së , kërkon nga AK-ja që të aplikojë nenit 72 , apo 57.2 të LPP-së duke kërkuar që të kërkojë sqarime dhe të verifikojë dokumentet lidhur me certifikatën ISO dhe Vertetimet Tatimore sikurse kontatimet në raportin ekspertit shqyrtues, poashtu edhe duke ju referuar pretendimeve ankimore të OE ankues ku gjatë vendimit të marë një vendim të drejtë dhe pa asnjë diskriminim sikurse parashihet në nenin 1,7 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I dhe II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: